

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shoqata e Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës: Nuk marrim pjesë, presim vendimin e Kushtetueses! - R EPORT.AL
ADRESA	https://report.al/shoqata-e-gjyqtareve-refuzon-ftesen-e-rames-nuk-marrim-pjese-presim-ve-ndimin-e-kushtetueses/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:00:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 07:51:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	024e3f3cf7ecca71f27889dd78ee5bc62c4b356085b055b9f49e5f010ec1e525
TEKSTI	a741f672bef53246903787b7deb8b5d83069be44e7cdde793bdf2f8ef26e62f8
PAMJA	a8a522d6eeb2d5d6f08ca0b7c34f52462781846ee2be725d3846c45c1b163c4f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	99edac4e2a1f283e2aa26354f2773fb312cb6423f035e05115afca0eeacab3a0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/99edac4e2a1f283e2aa26354f2773fb312cb6423f035e05115afca0eeacab3a0>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

[Home](#) [Aktualitet](#)

Shoqata e Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës: Nuk marrim pjesë, presim vendimin e Kushtetueses!

by **Sport Sport** — September 28, 2026 in Aktualitet, Kronikë, Kryesore0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Shoqata e gjyqtarëve i ka kthyer përgjigje kryeministrit Edi Rama lidhur me ftesën për takimin e planifikuar për sot, duke bërë me dije se nuk do të marrin pjesë në tryezën e diskutimit. Në një shkresë drejtuar kreut të qeverisë, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë shpreh vlerësimin për ftesën dhe nënvizon rëndësinë e dialogut institucional për çështjet me interes kombëtar. Megjithatë, Unioni argumenton se në këtë rast çështja e pagave është tashmë pjesë e një procesi kushtetues të nisur nga shoqatat e magistratëve dhe që nuk ka përfunduar ende në Gjykatën Kushtetuese.

Sipas Unionit, procesi lidhet drejtpërdrejt me kundërshtimin e ndryshimeve të bëra në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe me zbatimin e vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, për të cilin Unioni thotë se ka përcaktuar standardin minimal të pagës së magistratëve.

Pikërisht për këtë arsye, në shkresë theksohet se pjesëmarrja në tryezën e thirrur nga Rama, ndërsa çështja është ende në shqyrtim kushtetues, mund të cenonte kufijtë e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe parimet e ndarjes së pushteteve.

"Deri në një vendim marrje të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me padinë e paraqitur nga shoqatat e magistratëve, është e pamundur për ne pjesëmarrja në tryezën e konsultimit të datës 28 shtator 2026", thuhet në përgjigjen e Unionit. Megjithatë, Unioni sqaron se mungesa në takim nuk duhet të interpretohet si një mbyllje e dialogut institucional me qeverinë. Përkundrazi, gjyqtarët shprehen se mbeten të hapur për komunikim dhe dialog në një moment të përshtatshëm, pasi Gjykata Kushtetuese të ketë dhënë vendimin e saj. Në shkresë thuhet gjithashtu se Unioni dhe anëtarët e tij janë të gatshëm të kontribuojnë, brenda kompetencave kushtetuese dhe ligjore, në çdo proces institucional që synon një zgjidhje të qëndrueshme dhe në përputhje me parimet kushtetuese të një shteti demokratik.

Ftesa e Ramës ishte drejtuar institucioneve të drejtësisë dhe shoqatave të magistratëve për të diskutuar mbi një mekanizëm të ri për përcaktimin dhe rishikimin periodik të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Takimi ishte parashikuar të zhvillohej sot më 28 shtator, në një kohë kur përplasja për formulën e re të pagave vijon të jetë e hapur.

TË FUNDIT

Shoqata e Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës: Nuk marrim pjesë, presim vendimin e Kushtetueses!

SEPTEMBER 28, 2026

Merr flakë lokali në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, dyshohet për zjarrvënje të qëllimshme

SEPTEMBER 28, 2026

Tre operacione në Kukës e Tropojë/ 3 në pranga, sekuestrohen armë dhe 42 bimë kanabis

SEPTEMBER 28, 2026

Kthjellime dhe vranësira kalimtare/ Parashikimi i motit për sot, 28 shtator 2026

SEPTEMBER 28, 2026

Skandali tek SHISH/ Presidenti Begaj mbledh sot Këshillin e Sigurisë Kombëtare

SEPTEMBER 28, 2026

Horoskopi për sot, 28 shtator 2026/ Dashuria, financat dhe surprizat për 12 shenjat

SEPTEMBER 28, 2026

Alarm i kuq në Meksikë, uragani "Polo" pritet të prekë tokën të hënën mbrëma

SEPTEMBER 27, 2026

Përshkallëzohen tensionet Izrael-Turqi/ Netanyahu urdhëron përgatitjen e çështjes kundër Erdogan në Hagë

SEPTEMBER 27, 2026

Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë

SEPTEMBER 27, 2026

"Nesër më shumë!"/ Mbyllet protesta e 120 kundër Ramës në Tiranë

SEPTEMBER 27, 2026

[Previous Post](#)**Merr flakë lokali në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, dyshohet për zjarrvënje të qëllimshme**



Sport Sport

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT

Makina 150 mijë euro e Grida
Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?!
Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

01

0 SHARES



Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtesja e CFO
Pharma, Rexhina Bici pritet të drejtojë Fondin e
Sigurimeve

0 SHARES



Gazetari trondit me deklaratën: Dyshime të forta
për lidhjen e Neritan Nallbatit me Ergys Agasin

0 SHARES